

VENDIM
Nr. 33, datë 4.3.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ALPIQ ENERGY ALBANIA” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 8 dhe 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.3.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregutit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2, është plotësuar pjesërisht.

(Mungon vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata që personi përgjegjës nuk është i përfshirë në një proces penal.)

- Neni 9, pika 3, dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar pjesërisht:

(Bilanci financiar është paraqitur në gjuhën angleze).

- Neni 9, pika 4/10, germa “a” e plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “b” e plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “c” e plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 10 dhe nenit 11, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e tregutit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti